Thirrja është e hapur nga data 22.05.2026 deri me 29.05.2026

**TERMAT E REFERENCËS**

**SIGURIMI I TRANSPORTIT PËR REALIZIMIN E TRAJNIMIT DYDITOR NË KUADËR TË PROJEKTIT "PROMOVIMI DHE REALIZIMI I TË DREJTAVE TË ROMËVE NË KOSOVË DHE SHQIPËRI"**

| | |
|---|---|
| **Organizata** | **OJQ "NEVO KONCEPTI"** |
| **Objektiva** | **Ofrimi i transportit për realizimin e trajnimit dyditor për ngritjen e kapaciteteve të mobilizuesve të komunitetit, nw rajonin e Prevallws apo Brezovicws.** |

## 1. Të dhënat për Organizatën

OJQ "Nevo Koncepti" është organizatë joqeveritare e themeluar më 26 Nëntor 2014. Në themelimin e OJQ "Nevo Koncepti" kanë marrë pjesë intelektual të komunitetit Romë të cilët për shumë vite janë angazhuar në forma të ndryshme dhe kanë kontribuar në fuqizimin dhe avancimin e pozitës së komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian në pjesë të ndryshme të Kosovës sikurse në Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Pejë, Rahovec, Fushë Kosovë, Suharekë, Prishtinë, Mitrovicë, Klinë etj.

OJQ "Nevo Koncepti" bashkëpunon me fëmijë, të rinjë dhe familje të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian, me institucionet publike qendrore dhe lokale, organizata të shumta vendore dhe ndërkombëtare, media dhe palë tjera me interes.

**Rreth projektit:**

Projekti "Promovimi dhe Realizimi i të Drejtave të Romëve në Kosovë dhe Shqipëri" zbatohet nga konsorciumi i partnerëve: Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS), Nevo Koncepti (NVK), dhe Drejtësi Sociale (DS), në partneritet me Karl Kübel Stiftung (KKS), dhe me përkrahje financiare të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (BMZ) dhe Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS).

Projekti ka katër objektiva**:** Përmirësimi i përfshirjes në shkollë dhe i arsimit të fëmijëve romë; përmirësimi i integrimit në tregun e punës për romët; përmirësimi i aksesit në kujdesin shëndetësor për romët dhe përmirësimi i politikave të bazuara në të dhëna, zbatimi dhe vlerësimi për romët në Kosovë dhe Shqipëri.

Projekti zbatohet në shtatë komuna të Kosovës: Prishtinë, Prizren, Pejë, Ferizaj, Gjakovë, Mitrovicë e Jugut dhe Klinë, në 28 shkolla fillore.

## 2. Përshkrimi i shërbimeve të kërkuara

**Transporti**

- Organizimi i transportit me autobus komod brenda territorit të Kosovës për 32 persona.
- Nisja do të bëhet me datë 11 qershor 2026, ndërsa kthimi me datë 12 qershor 2026.
- Pjesëmarrësit duhet të merren nga qytetet:
    - Ferizaj: 5 persona,

- Prishtinë: 2 persona,
- Gjakovë: 9 persona,
- Klinë: 4 persona,
- Pejë: 6 persona,
- Prizren: 6 persona dhe
- Mitrovicë e Jugut: 1 person.

- Pjeswmarrwsit duhet tw dergohwn nw rajonin e Prevallws ose Brezovicws.
- Itinerarin e udhëtimit e organizon agjencia.
- Në kthim, pjesëmarrësit duhet të kthehen në të njëjtat lokacione nga ku janë marrë.

Numri i pjesëmarrësve mund të ndryshojë për (+/-) 5 persona. Numri final i pjesëmarrësve dhe qyteteve do të konfirmohet me kohë.

**3. Kushtet e pagesës**

Pagesa e shërbimeve do të realizohet pa TVSH, pasi Organizata "Nevo Koncepti" është e liruar nga TVSH, përmes xhirollogarisë bankare.

**4. Afati kohor**

Konfirmimi final për ofertën dhe numrin e pjesëmarrësve do të bëhet me kohë, në përputhje me marrëveshjen ndërmjet palëve.

**5. Rezultatet e pritshme**

- Bashkëpunim profesional dhe korrekt ndërmjet palëve.
- Respektimi i orareve të përcaktuara për nisje dhe kthim
- Përdorimi i mjeteve të transportit që plotësojnë standardet e sigurisë dhe komoditetit.
- Mbështetje logjistike për çdo ndryshim eventual gjatë kohëzgjatjes së programit.
- Shoferë me eksperiencë.
- Çmimet e ofruara të mbeten të pandryshuara gjatë periudhës së kontratës.

**6. Procedura e aplikimit**

Të gjithë të interesuarit duhet t'i dërgojnë këto dokumente:

- Oferta (të jetë e nënshkruar dhe e vulosur)
- Kopja e regjistrimit të biznesit me numër unik identifikues

**7. Kriteri i përzgjedhjes**

Do të përzgjidhet oferta ekonomikisht më e favorshme.

Aplikimi duhet të dërgohet jo më larg se data **29.05.2026** në adresën elektronike prokurimi@nevokoncepti.org apo në formë fizike në selin e OJQ''Nevo Koncepti'' në adresën Rr.Adnan Krasniqi nr.149, hyrja II Nr.8 Prizren.